



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 247, Datë 13.12.2021

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR DISA SHTESA NË RREGULLOREN “PËR LIDHJET E REJA NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES”, MIRATUAR ME VENDIMIN NR.166, DATË 10.10.2016, TË BORDIT TË ERE-S, E NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 7, pika 1, nenit 16, pika 3 dhe nenit 20, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 26, të Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 151 prot., datë 03.12.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Inspektiveve dhe Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Performances dhe Standardeve, “Mbi fillimin e procedurave për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren “Për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes”, miratuar me vendimin Nr.166, datë 10.10.2016, të bordit të ERE, e ndryshuar me Vendimin nr.177, datë 08.11.2016, të Bordit të ERE”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr.166, datë 10.10.2016, miratoi “Rregulloren për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes”, të ndryshuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.177, datë 08.11.2016.
- Lidhur me këtë Rregullore, Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), me shkresën nr. 5393 prot., datë 30.08.2021, ka paraqitur në ERE dy kërkesa për t’u reflektuar në Rregulloren “Për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes”.
- ISHTI, parashtron në ERE 2 (dy) kërkesa: së pari, përfshirjen në Rregulloren “Për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes” të detyrimit të subjektit që kërkon të pajiset me lidhje të re për të bërë regjistrimin pranë ISHTI-t përpara vënies në shfrytëzim (dhënies së tensionit) vërtetuar me dokumentin përkatës të lëshuar prej tij; dhe së dyti, në pikën 2.1, të kësaj Rregullore, për lidhje të reja në Tensionin e Ulët (TU), fuqia e instaluar 0 – 20 kW, të kërkohet nga ana e aplikantit, projekti elektrik përkatës.
- Bazuar në kuadrin ligjor në fuqi për mbikqyrjen e tregut në industrinë joushqimore, kërkesat e parashtruara nga ISHTI i shërbejnë harmonizimit të legjislacionit në fuqi dhe konkretisht mbikqyrjes dhe monitorimit të lidhjeve të reja në rrjetin e shpërndarjes dhe bazohen në ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; në ligjin nr. 10489, datë 15.11.2011, “Për tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i ndryshuar; në VKM-në nr. 245, datë 30.03.2016, “Për miratimin e rregullit teknik për kërkesat teknike në

instalimin dhe kontrollin e dispozitivit diferencial, vendosur në pajisjet dhe instalimet elektrike dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”; në VKM-në nr. 482, datë 17.06.2020, “Për miratimin e rregullit teknik për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së linjave elektrike me tension të lartë mbi 1 kV”, si dhe në VKM-në nr. 483, datë. 17.06.2020, “Për miratimin e rregullit teknik për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së instalimeve elektrike të tensionit të lartë mbi 1 kV”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për disa shtesa në Rregulloren “Për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes” së miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 166, datë 10.10.2016, i ndryshuar.
 - a. Tek pjesa II, ‘‘Dokumentacioni i kërkuar për aplikim për lidhje të re’’, Për Lidhje të Reja në TU, në pikën 2.1, pas pikës 2.1.6, propozohet të shtohet pika 2.1.7, me përmbajtje: Vërtetimin e regjistrimit pranë ISHTI-t përpara vënies në shfrytëzim (dhënies së tensionit) vërtetuar me dokumentin përkatës.
 - b. Tek pjesa II, ‘‘Dokumentacioni i kërkuar për aplikim për lidhje të re’’, Për Lidhje të Reja në TU, në pikën 2.1, pas pikës 2.1.8, propozohet të shtohet pika 2.1.8, me përmbajtje: Deklaratë instalimi dhe protokoll tokëzimi, i lëshuar nga inxhinier elektrik i pajisur me licencë.
2. Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Inspektimeve të njoftojë palët e përfshira për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI